

Sfidat e konsolidimit të shtetësisë: dialogu i Brukselit, dhjetë vjet pas pavarësisë të Kosovës

*Egzon Osmanaj**

Abstrakt

Dialogu Kosovë-Serbi është një nga proceset më të rëndësishme në të cilat Republika e Kosovës ka qenë e angazhuar që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Megjithatë, që nga fillimi, i ashtuquajturit “dialogu i Brukselit” është karakterizuar nga mungesa e transparencës, sinqeritetit si dhe nga shumëkuptimësia. Ky punim ka për fokus ndikimin që dialogu i Brukselit ka pasur në konsolidimin e shtetësisë së Kosovës. Punimi argumenton se dialogu Kosovë-Serbi e ka dëmtuar shtetësinë e Kosovës nga brenda dhe e ka dobësuar atë në sferën e jashtme. Përderisa në aspektin e brendshëm, marrëveshjet e arritura në këtë dialog kanë përbërë një sfidë serioze për sistemin juridik dhe politik të Kosovës, në arenën ndërkombëtare, dialogu ka qenë një pengesë në rrugën e Kosovës drejt konsolidimit të shtetësisë së saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. Dialogu i Brukselit është mjaft unik dhe i paprecedentë për literaturën e formimit dhe konsolidimit të shtetësisë për faktin se një shtet demokratik dhe sovran interferon, me ndihmën dhe përkrahjen e të gjithë aktorëve ndërkombëtarë, në organizimin dhe çështjet e brendshme të një shteti tjetër sovran dhe demokratik. Ky punim po ashtu shpërfaq dobësinë e BE-së si ndërmjetësues në këtë proces.

Fjalë kyç: *Dialogu i Brukselit, konsolidim i shtetit, demokratizim, integrimi evropian, Kosova, BE.*

* Egzon Osmanaj, hulumtues, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), egzoniosmanaj@hotmail.com, eosmanaj@kdi-kosova.org

Mosmarrëveshjet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë datojnë qysh nga fillimi i viteve të '90-ta. Qysh kur Slobodan Millosheviçi i suprimoi autonominë Kosovës në vitin 1989, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdimisht janë përkeqësuar, duke kulminuar me luftë në fund të '90-tave. Lufta përfundoi me një kampanjë bombardimi të NATO-s ndaj Jugosllavisë së Millosheviçit, i cili paraprakisht kishte refuzuar të nënshkruante një marrëveshje paqeje me Kosovën, e ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët, e cila do t'i kishte dhënë fund konfliktit duke i dhënë Kosovës një autonomi substanciale.

Pas luftës, Kosova kaloi pothuajse nëntë vite të një gjendje *status quo*-je: statusi i saj nuk po definohej ndërsa kishte mbetur protektorat i Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë, më 2005 ishin inicuar negociatat për zgjidhjen e statusit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga bashkësia ndërkombëtare. Por, të ashtuquajturat "bisedimet e Vjenës" nuk arritën të zgjidhin përfundimisht çështjen e statusit të Kosovës duke çuar në shpalljen e njëanshme të pavarësisë nga Kosova, me mbështetjen e shteteve të perëndimit. Si rrjedhojë, më 2011 nisi një proces i ri i bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nën lehtësimin e BE-së, me qëllim të adresimit të disa çështjeve që preknin direkt jetën e qytetarëve, siç është lëvizja e lirë apo njohja e ndërsjellë e diplomave, të cilat konsideroheshin si çështje teknike. Ky proces më vonë u avancua në dialog politik për normalizimin e marrëdhënieve i cili po vazhdon edhe sot.

Ky punim analizon ndikimin e dialogut të Brukselit¹ në procesin e konsolidimit të shtetësisë së Kosovës, në aspektin e

¹ Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është duke u zhvilluar paralelisht në dy nivele të ndryshme: në nivel teknik dhe politik. Meqë këto dy nivele të dialogut janë të lidhura ngushtë dhe me qëllim të shmangies së konfuzionit, ne i trajtojmë të dy nivelet si një proces i vetëm.

brendshëm dhe atë të jashtëm². Në aspektin e brendshëm, dialogu i Brukselit ka pasur për qëllim që të lehtësojë integrimin e komunitetit serb në jetën institucionale dhe të largojë influencën e Serbisë të ushtruar përmes institucioneve dhe aktiviteteve të saj paralele në Republikën e Kosovës. Në aspektin e jashtëm, dialogu është konsideruar si një mjet kyç i cili do të hapte rrugë për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, përfshirë OKB-në, duke çuar kështu në konsolidimin e plotë të shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Punimi argumenton se dialogu nuk ka kontribuar as në forcimin e shtetësisë së Kosovës nga brenda dhe as nuk ka kontribuar në konsolidimin e Republikës së Kosovës si një aktor i barabartë në sistemin ndërkombëtar. Përkundrazi, dialogu e ka ngadalësuar procesin e njohjeve të shtetësisë së Kosovës ngaqë shtetet të cilat kanë pasur mëdyshje në legalitetin dhe legjitimitetin e pavarësisë së Kosovës, janë duke pritur për rezultatin e dialogut, duke shpresuar që do ta qartësojë situatën. Në të njëjtën kohë, në aspektin e brendshëm, marrëveshjet që derivojnë nga dialogu i Brukselit, vetëm se e kanë formalizuar influencën dhe prezencën e Serbisë në Kosovë duke cënuar organizimin e brendshëm dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Po ashtu, punimi analizon rolin e BE-së në këtë proces, i cili është thënë të jetë lehtësues, por në realitet ai ka qenë ndërmjetësues që nga fillimi.

Në pjesën e parë, punimi bën një përmbledhje të dialogut të Brukselit që nga fillimi e deri më tani. Tutje, punimi analizon qasjen e BE-së ndaj dialogut. Në pjesën vijuese, punimi trajton

² Me konsolidim të brendshëm ne nënkuptojmë institucionet efektive si dhe kontrollimin dhe ushtrimin efektiv të sovranitetit në të gjithë territorin. Me konsolidim të jashtëm nënkuptojmë përfaqësimin e barabartë të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare, siç është OKB.

marrëveshjen e parë politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Në pjesën e fundit, diskutohen rezultatet e dialogut të deritanishëm.

Dialogu i Brukselit: një përmbledhje

Pas mendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me çështjen nëse Deklarata e njëanshme e pavarësisë nga institucionet e Kosovës ishte në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, u miratua një rezolutë e OKB-së e sponsorizuar nga Serbia dhe 27 vendet e BE-së, e cila bënte thirrje për një proces të ri të dialogimit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit të lehtësuar nga BE (OKB, 2010). Nëpërmjet kësaj rezolute, OKB nënvizonte se “Asambleja e Përgjithshme mirëpriste gatishmërinë e Bashkimit Europian për të lehtësuar një proces të dialogut ndërmjet palëve; procesi i dialogut në vete do të ishte një faktor për paqe, siguri dhe stabiliteti në rajon dhe ky dialog do të promovonte bashkëpunimin, do të arrinte progres në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe do të përmirësonte jetën e qytetarëve” (OKB, 2010, 2). Rezoluta erdhi si një tekst kompromisi ndërmjet Serbisë (e cila fillimisht kishte planifikuar një rezolutë që do ta sfidonte pavarësinë e Kosovës) dhe vendeve të Bashkimit Europian.

Qëllimi fillestar i dialogut ka qenë që të zgjidhë të gjitha çështjet e hapura ndërmjet dy vendeve dhe potencialisht të rezultojë më një marrëveshje ligjërish të obligueshme, e cila do t'i jepte fund konfliktit të gjatë duke normalizuar marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve (Bieber, 2015). Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është domosdoshmëri për të dy vendet për të përparuar në rrugët e tyre drejt Integritimit Europian (KE, 2018). Për më shumë, një marrëveshje ligjërish të obligueshme ndërmjet dy shteteve do t'i mundësonte Kosovës të anëtarësohet në organizata

ndërkombëtare, përfshirë BE-në, duke mundësuar kështu konsolidimin e plotë të shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në fillim, nuk kishte një udhërrëfyes të qartë të afateve kohore, e as një objektiv të definuar për procesin. Përkundrazi, ideja fillestare e përfaqësueses së lartë europiane, Catherine Ashton, ishte promovimi i dialogut ndërmjet dy vendeve me qëllim të uljes së tensioneve, relaksimit të marrëdhënieve bilaterale dhe arritjes së zgjidhjeve për disa nga çështjet kryesore që kanë qenë pengesë reale për Kosovën (Bieber, 2015). Kësisoj, BE-ja nuk kërkonte që të adresonte çështjen e shtetësisë së Kosovës, por kërkonte ta mënjanonte atë me qëllim të arritjes së progresit praktik në terren. Por, mënjanimi i çështjes së statusit të Kosovës prodhoi pasoja për procesin e dialogut. Më e rëndësishmja, kjo qasje e pengoi nënshkrimin e marrëveshjeve formale, gjë e cila do të kishte nënkuptuar se marrëveshjet janë ligjërisht të obligueshme (Bieber, 2015, f. 314). Duke tentuar që të shmangë çështjen e statusit me qëllim të arritjes së rezultateve të prekshme, BE, në të vërtetë, e dëmtoi procesin në përgjithësi dhe zbatimin e marrëveshjeve në veçanti.

Dialogu Prishtinë-Beograd³ filloi si një dialog teknik për shkak të insistimit të qeverisë së Kosovës se “dialogu politik nuk është në tavolinë” (Bajrami, 2013, f. 5). Megjithatë, derisa ky qëndrim ndryshoi me kohën, në realitet, dialogu ishte politik që nga fillimi. Ngjashëm, zotimi i Qeverisë së Kosovës se çështjet e brendshme nuk do të diskutohen me Serbinë, nuk u mbajtë, ngase shumë çështje të brendshme, përfshirë problemet që lidhen me veriun e Kosovës, u diskutuan dhe negociuan në dialog (Bieber, 2015; Bajrami, 2013).

³ Zyrtarisht, dialogu është i emëruar ‘Dialogu Prishtinë-Beograd’ dhe jo ‘Kosovë-Serbi’

Sidoqoftë, meqë procesi filloi si teknik dhe çështjet që ishin shtruar për diskutim ishin të natyrës teknike, ekipet negociuese nga të dy vendet nuk ishin të nivelit më të lartë. Delegacioni serb kryesohej nga Borko Stefanovic, i emëruar nga presidenti i atëhershëm serb, Boris Tadic, ndërsa delegacioni kosovar kryesohej nga Edita Tahiri, zëvendëskryeministre dhe ministre për dialog në qeverinë e atëhershme të Kosovës.

Dialogu teknik prodhoi disa marrëveshje të cilat synonin t'i zgjidhnin disa çështje jopolitike. Por, me kalimin e kohës u bë e qartë se zbatimi i këtyre marrëveshjeve teknike kërkonte vullnet politik. Prandaj, një dialogu i nivelit politik ishte i paevitueshëm. Dialogu politik, i cili filloi në vjeshtën e vitit 2012, solli në tryezë kryeministrat e dy vendeve, Hashim Thaçin e Kosovës dhe Ivica Daçiçin e Serbisë.

Dialogu i Brukselit është karakterizuar nga tensione dhe ndërprerje të shpeshta. Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 në të dyja vendet, zgjedhjet e BE-së, si dhe zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Serbi, ishin faktorë të rëndësishëm që kontribuan në ngadalësimin e procesit të dialogut. Po ashtu, tensionet e brendshme politike, në veçanti në Kosovë, paralizuan dialogun për gati dy vjet (Koha Ditore, 2014). Pavarësisht kësaj, deri më tani, mbi 23 marrëveshje janë arritur (Zyra e KM, Raportet për dialogun). Megjithatë, shumica e tyre ende nuk janë zbatuar.

Që nga fillimi, procesi i dialogut është kritikuar për mungesë transparence dhe llogaridhënie (KDI, 2016). Mungesa e transparencës ka qenë problematike ngase qytetarët e zakonshëm nuk e kanë idenë se si zbatimi i marrëveshjeve do të ndikojë në jetën e tyre (KDI, 2016). Rrjedhimisht, qytetarëve të zakonshëm nga të dy komunitetet u ka munguar vullneti dhe gatishmëria për t'u angazhuar dhe lehtësuar zbatimin e

marëveshjeve. Për më tepër, në shumë raste, ata i kanë rezistuar zbatimit të marrëveshjeve të dialogut⁴.

Në të njëjtën kohë, për shkak të qasjes nga lartë-poshtë, marrëveshjet kanë pasur pak mundësi për të ndikuar direkt në pajtimin ndëretnik në Kosovë, ngase këto marrëveshje vështirë se mund të zbatohen plotësisht pa mbështetjen e atyre qytetarëve për të cilët janë të dedikuara këto marrëveshje. Kësisoj, dialogu ka qenë më shumë një proces përjashtues dhe “pakt elitash”, sesa një proces gjithëpërfshirës që synon të trajtojë problemet reale të banorëve të Kosovës.

Së pari stabiliteti, pastaj demokracia. A është BE-ja përgjegjës?

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është i një rëndësie të veçantë për vetë BE-në. Ai ishte konsideruar një mundësi e mirë për të arritur disa rezultate pozitive në fillim të punës për Shërbimin e Jashtëm European (ShJE) të sapoformuar dhe kryesuar nga Catherine Ashton. Dialogu ka qenë po ashtu një test për BE-në si ndërmjetësues dhe “aftësinë e saj për të përdorur procesin e anëtarësimit për të adresuar konfliktet e tejzgjatura” (Bieber, 2015, 290). Prandaj, ShJE dhe në veçanti përfaqësuesja e lartë Ashton dhe pasuesja e saj Federica Mogherini, kanë qenë maksimalisht të përkushtuara në këtë proces.

Sidoqoftë, BE është treguar e pafuqishme deri më tani, në raport me këtë proces të komplikuar dhe të brishtë. Bieber (2015) argumenton se qasja nga lartë-poshtë e BE-së “ka lënë hapësirë të konsiderueshme për interpretime të ndryshme dhe në konflikt me njëra-tjetrën, të elementeve kryesore, që rezultoi

⁴ Raste të tilla janë hasur me marrëveshjen për krijimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe marrëveshjen për rivitalizimin e Urës mbi lumin Ibër në Mitrovicë.

në mungesë të zbatimit të marrëveshjeve (f. 290). Rrjedhimisht, deri më sot, shumica e marrëveshjeve nuk janë zbatuar plotësisht apo nuk kanë filluar të zbatohen fare. Zbatimi i marrëveshjeve është ndikuar gjithashtu nga qasja e “shumëkuptimësisë (ambiguitetit) kreativ”, të cilën BE e ka përdorur për të paraqitur sukses në ato raste ku, në të vërtetë, ka pasur shumë pak progres (Bieber, 2015, f. 297). Në këtë mënyrë, shumëkuptimësia e marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në dialogun e Brukselit, e ka komplikuar zbatimin e tyre, meqë të dy palët e kanë pasur versionin dhe interpretimin e tyre të këtyre marrëveshjeve.

Kjo qasje e BE-së ka çuar edhe në mungesë transparence dhe llogaridhënie, që është një nga pikat më të dobëta të dialogut (Beha, 2015). Publiku kosovar, shoqëria civile madje dhe opozita me deputetët e saj, në shumicën e rasteve, janë informuar nga mediat vetëm pasiqë marrëveshjet janë nënshkruar (KDI, 2016). Për shembull, ish-kryeministri Isa Mustafa, kishte raportuar vetëm një herë gjatë mandatit të kaluar në Kuvendin e Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me dialogun Kosovë-Serbi (KDI, 2018).

Një tjetër shqetësim që ka të bëjë me rolin e BE-së në këtë proces është se dialogu dhe faktorët që e kanë ndikuar atë, kanë pasur prioritet ndaj çështjeve të lidhura me sundimin e ligjit, përfshirë funksionimin e EULEX-it. Meqë paparashikueshmëria e lidhshimit kosovar implikon një shkallë të pasigurisë në raport me stabilitetin e rajonit, EULEX-i ka marrë instruksione, madje është bërë edhe presion nga Brukselit, që të mos ‘trazojë’ dialogun dhe aktorët e përfshirë në dialog (Jackson, 2015). Luftimi i korrupsionit ndaj profileve të larta dhe krimit të organizuar, që potencialisht do të përfshinte eliten politike kosovare, do të paraqiste rrezik për destabilizim dhe gjithashtu do të eliminonte partnerët negociues të BE-së. Kështu, disa elita, që janë kritike për dialogun, kanë pasur

ekstra imunitet nga BE-ja dhe komuniteti ndërkombëtar, për hir të stabilitetit (Capussela 2015; Jackson, 2015). Për më tepër, duke e shtyrë Qeverinë e Kosovës që të angazhohet më shumë në dialog me BE-në sesa me parlamentin e saj, BE po minon dhe dëmton funksionimin e shtetit të cilin është duke e ndihmuar që të ndërtohet (Hoogenboom, 2011). Në të njëjtën kohë, duke i dhënë prioritet stabilitetit në kurriz të demokratizimit, BE-ja po minon vlerat e saj fundamentale dhe reputacionin e saj si aktor normativ.

Një tjetër çështje shqetësuese është paaftësia e BE-së për të pasur një zë dhe qëndrim të përbashkët në raport me Kosovën. Roli i BE-së si ndërmjetësues në dialog është përcaktuar kryesisht nga pesë shtetet e saj që nuk e kanë njohur shtetësinë e Kosovës, duke e penguar kështu edhe ofrimin e një perspektive të qartë dhe kredibile europiane për Kosovën. Neutraliteti i BE-së ndaj pavarësisë së Kosovës e ka dëmtuar kredibilitetin e BE-së në sytë e publikut dhe autoriteteve kosovare. Por, disa diplomatë europianë argumentojnë se duke mos e njohur Kosovën pesë vendet e BE-së, e “kanë ndihmuar BE-në të bëhet lehtësuesi më i mirë i mundshëm në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës” (cituar në Palokaj dhe Tuhina, 2016). Një nga zyrtarët e lartë të BE-së i përfshirë në lehtësimin e dialogut pranon se “kjo ka qenë po ashtu një përparësi, sepse na ka mundësuar neve [BE-së] që të jemi lehtësuesi më i mirë i mundshëm në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duke qenë neutral. Ne u themi kosovarëve se pavarësia e tyre është një çështje e kryer sepse shumica e vendeve të BE-së e njohin atë, ndërsa serbëve u themi se pesë vende anëtare ende nuk e kanë njohur Kosovën, kështu që ne jemi neutral ndaj statusit të saj” (Palokaj dhe Tuhina, 2016, f. 12).

Pavarësisht kësaj, parë nga një këndvështrim pozitiv, BE-ja e ka ndërlidhur procesin e anëtarësimit të Serbisë në BE me

çështjen e statusit të Kosovës nëpërmjet disa vendeve anëtare të saj, të cilat kanë kërkuar një rol më konstruktiv të Serbisë në raport me Kosovën, si një parakusht për pranimin e aplikimit për anëtarësim në BE të Serbisë (Bieber, 2015). Individualisht, Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar, e kanë kushtëzuar progresin e Serbisë drejt anëtarësimit në BE me progresin e dialogut me Kosovën, duke sinjalizuar kështu se normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën është i pashmangshëm për Serbinë në mënyrë që të konsiderohet aplikimi i saj për anëtarësim (Gazeta Zëri, 2016). Ky qëndrim i ka dhënë fund ambicies së qeverisë së Serbisë që ta ndajë procesin e anëtarësimit në BE nga qëndrimi dhe marrëdhëniet e saj me Kosovën.

Kësisoj, përfshirja e BE-së në këtë proces ka qenë vendimtare ngaqë vullneti dhe dëshira e të dy vendeve për dialog dhe kompromise, kanë qenë të ngulitura në procesin e anëtarësimit në BE. Për Kosovën, marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ka qenë shpërblimi i ofruar nga BE, përderisa karrota e Serbisë ka qenë statusi i kandidatit dhe hapja e negociatave për anëtarësim.

Në kërkim të normalizimit: Marrëveshja e Prillit dhe normalizimi i marrëdhënieve

Gjate periudhës 2011-2012, Kosova dhe Serbia arritën disa marrëveshje teknike të cilat mëtonin të përmirësonin jetën e qytetarëve të Kosovës, në veçanti të ndihmonin integrimin e komunitetit serb në jetën institucionale dhe shoqërore të Republikës së Kosovës. Megjithatë, siç u tha edhe më lartë, pavarësisht faktit se këto marrëveshje u konsideruan teknike, zbatimi i tyre kërkonte vullnet politik nga të dy palët. Në këtë mënyrë, me qëllim të arritjes së këtij vullneti politik për zbatimin e marrëveshjeve, paralelisht me procesin e dialogut teknik, filloi dialogu politik, si proces për normalizimin e

marrëdhënieve. Në nivelin politik të dialogut, të dy vendet përfaqësoheshin në nivel të kryeministrave dhe rrjedhimisht, vëmendja dhe rëndësia që iu dha këtij procesi, bëri që ta lërë nën hije dialogun teknik.

Rreth gjashtë muaj nga fillimi i dialogut në nivel politik, më 19 prill 2013, nën lehtësimin e BE-së, u nënshkrua marrëveshja e parë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, e njohur ndryshe edhe si Marrëveshja e Prillit apo Marrëveshja e Brukselit. Kjo marrëveshje u konsiderua si pikënisje e një procesi të gjatë të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Beha, 2015). Në të njëjtën kohë, marrëveshja u cilësua si një e arritur historike në marrëdhëniet Kosovë-Serbi dhe një zhvillim i jashtëzakonshëm për të ardhmen europiane të të dy vendeve (Bieber, 2015).

Marrëveshja e Prillit është konsideruar të jetë e një rëndësie të veçantë për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ngase është marrëveshja e parë ndërkombëtare e arritur ndërmjet dy vendeve që nga shpallja e pavarësisë nga Kosova më 2008. Deri në prill të 2013, të gjitha marrëveshjet në raport me marrëdhëniet Kosovë-Serbi janë arritur ndërmjet bashkësisë ndërkombëtare dhe njëres nga palët, por jo ndërmjet Kosovës dhe Serbisë (Mehmeti, 2013). Në këtë mënyrë, Marrëveshja e Prillit është një sinjal që Serbia ka lëvizur nga pozicioni i saj i mëhershëm dhe mund të përballet me Kosovën në terma të barabartë. Nga ana e Kosovës, marrëveshja është konsideruar si “historike” dhe e cila nënkupton “njohjen faktike” të Kosovës nga Serbia (Beha, 2015).

Një tipar i rëndësishëm i Marrëveshjes së Prillit ka qenë i ashtuquajturit “ambiguiteti kreativ/konstruktiv” i cili ka shmangur adresimin e qartë dhe direkt të statusit të Kosovës (Marrëveshja e parë e parimeve, 2013). Delegacionet janë të konsideruara si “palë” pa ndonjë detaj apo indikacion rreth

shtetësisë së Kosovës. Në të vërtetë, arritja e Marrëveshjes së Prillit ishte e mundur pikërisht falë kësaj qasjeje të ambiguitetit kreativ/konstruktiv. Në të kundërtën, çdo përfshirje direkte apo indirekte e statusit të Kosovës do ta pamundësonte arritjen e saj.

Sidoqoftë, parë nga një këndvështrim tjetër, Marrëveshja e Prillit prek disa çështje të ndjeshme të organizimit të brendshëm të Kosovës përfshirë drejtësinë, policinë si dhe sistemin politik. Në gjashtë nenet e para të saj, marrëveshja përmban parimet e përgjithshme për themelimin e një Asociacioni/Bashkësie të komunave me shumicë serbe. Sipas këtyre pikave të Marrëveshjes së Prillit, një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe do të themelohet në Kosovë dhe do të ketë vështrim të plotë në fushën e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë si dhe planifikimit urban dhe rural (Marrëveshja e parë e parimeve, 2013, pika 4). Për më tepër, sipas pikës së dytë të kësaj marrëveshjeje, Bashkësia/Asociacioni do të themelohet me anë të statutit të dekretuar nga qeveria dhe shpërbërja e tij do të mund të bëhet vetëm nga 2/3 e anëtarëve të tij (Marrëveshja e parë e parimeve, 2013, pika 2).

Ideja e një Asociacioni/Bashkësie me kompetenca ekzekutive, siç parasheh kjo marrëveshje, shkon përtej Pakos së Ahtisaarit dhe rrjedhimisht, edhe përtej Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat janë rezultat i një kompromisi për pavarësinë e Kosovës. Ky Asociacion/Bashkësi e sfidon parimin bazë të Kushtetutës, multietnicitetin, i cili është promovuar vazhdimisht nga bashkësia. Ky argument është validuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Më 23 dhjetor 2015, pasi që presidentja e atëhershme, Atifete Jahjaga, kishte dërguar në Gjykatën Kushtetuese lëndën lidhur me përputhshmërinë e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe dhe parimeve/elementeve

kryesore të saj me frymën kushtetuese, Gjykata kishte vendosur se “parimet e elaboruara në Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe në Kosovë - parimet/elementet kryesore, nuk janë plotësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës, neni 3 (Barazia para ligjit), paragrafi 1, Kapitulli 2 (Liritë dhe të drejtat fundamentale) dhe kapitulli 3 (të drejtat e komuniteteve anëtarëve të tyre) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës” (Gjykata Kushtetuese, 2015). Që nga ky vendim, formimi i Asociacionit/Bashkësisë është pezulluar.

Është argumentuar se formimi i Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe nënkupton, de facto, një nivel të tretë qeverisës në Kosovë që është në shpërputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e aplikueshme (KIPRED, 2013). Jackson (2015) argumenton se Asociacioni i komunave serbe (AKS) paraqet një entitet të unifikuar serb, i zhvendosur nga sistemi qëndror, me fuqinë për të marrë vendime ligjërish të obligueshme. AKS do të ketë pushtet veçanërisht në fushën e drejtësisë dhe policisë.

Sipas marrëveshjes, Asociacioni/Bashkësia do të ketë një komandant rajonal të policisë, etniciteti i të cilit duhet të jetë serb dhe i cili do të propozohet nga AKS dhe miratohet nga Prishtina dhe Beogradi. Ky është një rast i paprecedent kur një vend i pavarur dhe sovran i delegon pushtet në çështjet e saj të sundimit të ligjit një qeverie të një shteti tjetër.

Përveç kësaj, AKS krijon një nivel të tretë të pushtetit në Kosovë, diku ndërmjet pushtetit lokal dhe qëndror. Marrëveshja e Prillit parasheh që AKS të ketë ‘vështrim të plotë’ në fushën e arsimit (që aktualisht është kompetencë e Ministrisë së Arsimit), zhvillimit ekonomik (kompetencë e komunave), shëndetësisë (kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë) dhe zhvillimit urban dhe rural (kompetencë e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit hapësinor) (Beha, 2015). Ligji për vetëqeverisjen lokale thekson se “asociacione të tilla mund t’u

ofrojnë anëtarëve të saj disa shërbime, përfshirë trajnime, ngritje të kapaciteteve, asistencë teknike si dhe hulumtime mbi kompetencat e komunave dhe rekomandime të politikave në përputhje me ligjin” (Beha, 2015, f. 115). Por, asociacione të tilla siç është për shembull, Asociacioni i komunave të Kosovës, nuk kanë asnjë kompetencë ekzekutive dhe janë të cilësuara si OJQ. Prandaj, Marrëveshja e Prillit e krijon një nivel të tretë të pushtetit në Kosovë, sepse AKS, për dallim nga Asociacioni i komunave të Kosovës, do të ketë pushtet të zgjeruar (Beha, 2015, f. 118).

AKS është gjithashtu në kundërshtim me Kartën Europiane për Vetëqeverisje Lokale, të cilës i referohet marrëveshja për AKS-në. Në vend që t’i sjellë shërbimet institucionale më afër qytetarëve – që është parimi bazë i kësaj karte - subsidiariteti e kërkon, formimi i AKS-së nënkupton saktësisht të kundërtën: centralizimin e vendimmarrjes dhe shërbimeve institucionale (shih: Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, 1985).

Përveç këtyre argumenteve, ekziston gjithashtu mundësia që ky trup të kapet dhe kontrollohet nga radikalët serb. Kjo frikë është e bazuar në një ‘krijesë’ tjetër të Marrëveshjes së Prillit, Listën Serbe. Duke synuar motivimin e serbëve të Kosovës për t’u integruar në institucionet e Kosovës dhe të marrin pjesë në zgjedhje, marrëveshja ndërmjet dy kryeministrave të atëhershëm, Thaçi dhe Daçiç, parashihte formimin e kësaj liste. Por, ndryshe nga qëllimi për të cilin kjo listë ishte formuar - që ishte integrimi i serbëve të Kosovës në jetën institucionale dhe përfaqësimi më i mirë i tyre, në fakt, rezultatet ishin të kundërta. Në zgjedhjet lokale të 2013-s, Lista Serbe me bazë dhe e kontrolluar nga Beogradi, fitoi shumicën e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Kësisoj, përveç në komunat veriore, Lista Serbe i mundësoi qeverisë së Serbisë që ta zgjerojë kontrollin e saj edhe në komunat me shumicë serbe në jug të Kosovës. Për më tepër, duke i etiketuar politikanët serbë të

Kosovës si partnerë besnikë të qeverisë së Kosovës, Lista Serbe, e ndihmuar edhe nga mediat lokale, inicioi një kampanjë kundër tyre duke i eliminuar kështu nga skena politike (GazetaExpress, 2017). Në këtë mënyrë, në vend se të përkrahen politikanët serbë të Kosovës të cilët në vazhdimësi kanë qenë të angazhuar në avancimin e interesave të serbëve lokalë nëpërmjet integritit dhe pjesëmarrjes në jetën institucionale dhe shoqërore të Kosovës, dialogu i Brukselit i penalizoi ata duke vendosur një elitë të re të politikanëve serbë në Kosovë, nacionalistë të devotshëm dhe të kontrolluar nga Beogradi.

Një tjetër pikë me rëndësi e Marrëveshjes së Prillit është drejtësia. Me qëllim të integritit të strukturave paralele të drejtësisë në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës, marrëveshja, ndër të tjera, parasheh krijimin e një paneli me shumicë serbe të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë (Marrëveshja për Drejtësinë, 2015). Ky panel do të trajtojë të gjitha rastet që kanë të bëjnë me serbët nga e gjithë Kosova. Ndërsa, përbërja e tij do të jetë dyetnike, serbë dhe shqiptarë. Duke e vendosur etninë si kriter, kjo pikë e marrëveshjes bie në kundërshtim me parimin e mosdiskriminimit në baza etnike të Kushtetutës së Republikës Kosovës (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008). Për më tepër, themelimi i një paneli të Gjykatës së Apelit, i cili do të ketë jurisdiksion vetëm mbi serbët e Kosovës, çënon sistemin unitar të drejtësisë në Kosovë.

Marrëveshja gjithashtu parasheh shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë në pjesën veriore të Kosovës. Në fakt, ajo vetëm se i ka legjitimuar këto struktura duke i integruar ato në sistemin juridik të Kosovës (Mehmeti, 2013). Para se të arrihet marrëveshja, Beogradi kishte ndikim të theksuar në komunat veriore të Kosovës, gjë e cila ishte kritikuar dhe kundërshtuar vazhdimisht nga Qeveria e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare. Ndërsa, falë kësaj marrëveshjeje, Serbia jo vetëm se e legjitimoi ndikimin e saj në pjesën veriore të

Kosovës, por e zgjeroi ndikimin e saj edhe në pjesët tjera të Kosovës (Beha, 2015; Bieber, 2015).

Në fund, Marrëveshja e Prillit është vetëm 'një pikë në oqean' ngase normalizmi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është ende larg me një Serbi që vazhdon ta bllokojë Kosovën në arenën ndërkombëtare. Dialogu në përgjithësi dhe Marrëveshja e Prillit në veçanti, kanë dështuar që të adresojnë çështjet më të rëndësishme, përfshirë drejtësinë tranzicionale dhe, në veçanti, fatin e personave të pagjetur. Për më keq, këto dhe çështje të tjera të përballjes me të kaluarën, nuk pritet që të trajtohen as në fazën e ardhshme të dialogut, me të cilën përfundimisht pritet që të përmbillet ky process.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)

Për të dy vendet, dialogu i lehtësuar nga BE-ja erdhi para fillimit të procesit të anëtarësimit në BE. Kësisoj, dëshira dhe vullneti për të treguar interesin dhe gatishmërinë e tyre për të avancuar në rrugën e tyre drejt BE-së, kanë qenë faktorë kryesorë që mundësuan disa koncesione lidhur me marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Si shpërblim kryesor për këto lëshime, Serbisë i ishte ofruar hapja e negociatave për anëtarësim, përderisa Kosovës i ishte ofruar Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit (MSA), e cila ishte konsideruar e një rëndësie të veçantë për Kosovën meqë ishte marrëveshja e parë kontraktuale e saj me BE-në.

Negociatat për MSA-në ndërmjet Kosovës dhe BE-së filluan në tetor të vitit 2013, pikërisht si shpërblim për arritjen e Marrëveshjes së Prillit në kuadër të dialogut me Serbinë. MSA u inicua në korrik 2014, ndërsa u nënshkrua një vit më vonë, pothuajse dy vjet pas fillimit të negociatave. Kësisoj, MSA ka qenë përfitimi kryesor i Kosovës nga dialogu i deritanishëm me Serbinë.

MSA-ja paraqet hapin e parë formal për vendet e Ballkanit drejt anëtarësisht në BE. Në këtë mënyrë, përtej retorikës se Kosova ka të ardhme europiane, nënshkrimi i MSA-së përbën hapin e parë praktik në këtë drejtim. MSA-ja ofron një mundësi të jashtëzakonshme për Kosovën për qasje në tregun e BE-së dhe po ashtu zbatimi i saj do të prodhojë rezultate të rëndësishme për Kosovën të cilat do ta ndryshojnë vendin pozitivisht. Nga zbatimi i MSA-së Kosova do të përfitojë në shumë sfera, përfshirë ekonominë, sundimin e ligjit, arsimin, industrinë, ambientin, sistemin energjetik etj. Për më tepër, përveç efekteve të saj pozitive në marrëdhëniet tregtare të Kosovës me BE-në, MSA-ja është një instrument shumë i rëndësishëm në luftën ndaj trafikimit, pastrimit të parave dhe terrorizimit (Palokaj & Tuhina, 2016). Siç argumentojnë Palokaj dhe Tuhina (2016), MSA-ja padyshim se ka rëndësi historike për Kosovën, pa ekgzagerim, MSA-ja e Kosovës me BE-në përfundimisht e përmyll përpyekjen e gjatë për ndërtimin e një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe BE-së (f. 5). Në të njejtën kohë, duke përmyllur MSA-në me Kosovën, BE-ja përfundoi një proces mjaft të gjatë i cili kishte filluar në fund të vitit 2000.

MSA-ja me Kosovën është e një rëndësie të veçantë ngase pavarësisht neutralitetit të BE-së ndaj Kosovës, BE-ja arriti të nënshkruajë MSA-në me Kosovën⁵. Kësisoj, pavarësisht qasjes neutrale dhe të paqartë të BE-së ndaj Kosovës, MSA-ja dëshmoi se nëse Kosova i përmbush kushtet e BE-së, kjo e fundit është

⁵ MSA-ja me Kosovën ishte e mundur të arrihej falë ndryshimeve që ka sjellur traktati i Lisbonës, i cili i jep personalitet legal BE-së, duke nënkuptuar që Komisioni Europian mund të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare duke shmangur ratifikimin nga shtete anëtare të BE-së. Nëse MSA-ja me Kosovën do të duhej të ratifikohej nga shtetet anëtare të BE-së, do të ishte një mision i pamundur për tu arritur për shkak të pesë vendeve të BE-së të cilat nuk e njohin Kosovën.

në gjendje që të gjejë një zgjidhje praktike me qëllim të avancimit të procesit të integrimit të Kosovës.

Megjithatë, janë disa elemente që e dallojnë MSA-në në rastin e Kosovës prej atyre të vendeve të tjera të rajonit. Palokaj dhe Tuhina (2016) argumentojnë se fakti që kjo marrëveshje është e ndryshme nga marrëveshjet e tjera të BE-së me vendet e rajonit në terma ligjorë, përbën një shqetësim për integrimin e plotë të Kosovës në BE. Për shembull, BE-ja nuk e merr përsipër obligimin që zbatimi i plotë i MSA-së të ndiqet nga një avancim i afrimit me Kosovën, sikurse është rasti me vendet e tjera (Palokaj & Tuhina, 2016). Në MSA-të e Serbisë apo Shqipërisë, kapitulli i dialogut politik thekson integrimin e plotë në komunitetin e vendeve demokratike dhe një afrim gradual drejt BE-së si disa nga objektivat kyçe të dialogut politik (Palokaj & Tuhina, 2016, 15-16). Në rastin e Kosovës, nuk ka një referencë të qartë që tregon se zbatimi i MSA-së çon në integrimin e plotë në BE, siç është rasti me vendet e tjera. Kësisoj, për shkak të pengesave ligjore që lidhen me statusin e saj, Kosova nuk do të jetë në gjendje që të ndërmarrë hapin e radhës të cilin çdo vend e ka ndërmarrë pas nënshkrimit të MSA-së: aplikimi për statusin e kandidatit.

Për më tepër, klauzola “nëse rrethanat objektive lejojnë” pason kur marrëveshja thekson disa objektiva kryesore. Për shembull, neni 11 i dialogut politik thotë se dialogu ‘ka për qëllim të promovojë në veçanti pjesëmarrjen e Kosovës në komunitetin demokratik ndërkombëtar’, e pasuar nga fjalia ‘nëse rrethanat objektive lejojnë’ (MSA, 2015). Kjo e bën mjaft të paqartë perspektivën e integrimit europian të Kosovës. Në të njëjtën kohë, në vend të *integrimit europian*, në rastin e Kosovës përdoret termi *perspektivë europiane*, që është një term i gjerë dhe i paqartë (Palokaj & Tuhina, 2016). Për më shumë, meqë mundësia për anëtarësim është e rezervuar vetëm për shtete dhe BE-ja nuk e njeh formalisht Kosovën si të tillë, edhe zbatimi

i plotë i MSA-së nuk garanton një perspektivë të qartë të anëtarësisimit. Kjo qasje e shumëkuptimtë është përdorur edhe nga Komisioni Europian, në Strategjinë e zgjerimit, publikuar në shkurt të 2018-s (KE, 2018).

Megjithatë, është e rëndësishme të nënvizohet që MSA-ja nuk është garanci për integrim në BE. Padyshim se është një përfitim dhe mundësi e rëndësishme për t'i përmbushur kushtet dhe standardet e kërkuara për t'u bërë anëtar i BE -së. MSA-ja është kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për anëtarësim në BE, veçanërisht në rastin e Kosovës dhe Serbisë, ku mospajtimet e pazgjidhura territoriale dhe marrëdhëniet e tensionuara përbëjnë një pengesë të madhe për të dy vendet në rrugët e tyre drejt integritimit europian. Normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është ritheksuar edhe në strategjinë e zgjerimit si një parakusht kyç për të dy vendet në mënyrë që të avancojnë në rrugët e tyre respektive të integritimit europian (KE, 2018).

Rezultatet e dialogut

Kur filloi dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, në mars të vitit 2011, nuk kishte një objektivi të definuar për këtë proces. I gjithë procesi filloi si një përpjekje për të reduktuar tensionet dhe prodhuar zgjidhje për disa nga çështjet kryesore që janë pengesa reale për Kosovën (Bieber, 2015). Në të njëjtën kohë, zyra e sapoformuar e Shërbimit të Jashtëm në Bruksel ishte e etur për sukses në ditët e saj të para dhe dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit ofronte një mundësi të mirë për këtë (Bieber, 2015). Megjithatë, rezultatet e dialogut të deritanishëm janë mjaft të komplikuar. Vërtet situata në terren, veçanërisht në veri të Kosovës, ka filluar gradualisht të përmirësohet, megjithatë shumica e marrëveshjeve të arritura, përfshirë atë të 19 prillit, janë ende larg zbatimit.

Në të vërtetë, zbatimi i marrëveshjeve të dialogut ka dalë të jetë një problem mjaft i madh. Nga mbi 23 marrëveshje të arritura deri më tani, vetëm katër prej tyre janë zbatuar plotësisht, përdërisa pjesa tjetër e marrëveshjeve ose kanë stagnuar në fazën e parë të zbatimit ose zbatimi i tyre nuk ka filluar fare. Kësisoj, zbatimi i shumicës së marrëveshjeve ose është zvarritur, ose nuk ka filluar fare. Strukturat paralele të Serbisë janë ende aktive ndërsa serbët e Kosovës ende nuk janë integruar në sistemin e Kosovës (Parlamenti European, 2017). Probleme të ngjashme janë vërejtur edhe me zbatimin e marrëveshjes për Energji të 2015-s, zbatimi i së cilës po zvarritet dhe zbatimin e marrëveshjes për kodin telefonik, e cila vetëm së fundmi ka filluar të zbatohet (Parlamenti European, 2017). Rezultate të ngjashme kanë prodhuar edhe marrëveshjet për njohjen e ndërsjellë të diplomave dhe lëvizjen e lirë, të cilat ende mbesin pjesërisht ose aspak të zbatuara.

Vështirësitë në zbatimin e marrëveshjeve të arritura në diaogun e Brukselit janë rezultat i një sërë faktorësh. Së pari, moszbatimi i këtyre marrëveshjeve është rezultat i përjashtimit të serbëve lokalë nga procesi, të cilët ndihen të braktisur nga qeveria e Serbisë dhe po ashtu të lënë anësh nga qeveria e Kosovës (Beha, 2015; Bieber 2015). Të ndikuar nga mediat nacionaliste serbe dhe diskursi publik se këto marrëveshje çojnë në njohjen e shtetësisë së Kosovës nga serbët lokalë dhe vetë Serbia, ata kanë refuzuar që të jenë pjesë e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit. Kësisoj, kur ka qenë e mundur, serbët lokalë e kanë penguar zbatimin e këtyre marrëveshjeve shpesh duke e akuzuar Serbinë se po e shet Kosovën dhe serbët e Kosovës (OBCT, 2010).

Së dyti, një tjetër faktor që ka ndikuar negativisht në zbatimin e marrëveshjeve të dialogut të Brukselit është qasja e ashtuquajtur “ambiguitet kreativ/konstruktiv”. Duke e përdorur këtë qasje, BE-ja e ka lënë në diskrecion të palëve t’i

interpretojnë marrëveshjet në mënyrën që ato duan. Kjo qasje është përdorur nga BE në mënyrë që të arrihen rezultate në praktikë, duke shmangur çështje të cilat do ta pengonin procesin, përfshirë çështjen e statusit të Kosovës. Edhe pse kjo qasje ka qenë mjaft frytdhënëse për arritjen e marrëveshjeve në shumë fusha, ajo është shfaqur të jetë një problem serioz gjatë fazës së zbatimit të tyre. Por, disa argumentojnë se marrëveshje me të qarta dhe njëkuptimore do të ishte e pamundur që të arrihen (Van Der Borgh et al., 2016).

Përveç problemeve me zbatimin e marrëveshjeve, dialogu i Brukselit gjithashtu ka dështuar deri më tani që të zgjidhë çështjen e përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Anëtarësimi i Kosovës në organizata ndërkombëtare, siç është rasti i aplikimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), është penguar nga Serbia dhe fushata e saj anti-Kosovë. Kampanja dhe lobimi serb kundër Kosovës, vazhdojnë të jenë pengesat kryesore edhe për anëtarësimin potencial të Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Përderisa pjesë e marrëveshjes së 19 prillit ka qenë edhe zotimi i dy palëve se nuk do të bllokojnë njëra-tjetrën në rrugën e tyre drejt anëtarësimin në BE, një gjë e tillë nuk i është kërkuar Serbisë nga BE-ja kur është në pyetje anëtarësimi në OKB. Në anën tjetër, Kosova ka qenë e pafuqishme që të bëjë presion ndaj BE-së për të arritur ndonjë marrëveshje apo për të marrë një zotim të Serbisë që do t'i hapte rrugë Kosovës për anëtarësim në OKB. Është e habitshme se si Kosova nuk ka qenë më këmbëngulëse në kërkesat e saj për të arritur një zgjidhje praktike që do t'ia mundësonte anëtarësimin në OKB, duke pasur parasysh se anëtarësimi në OKB është i një rëndësie jetike për konsolidimin e shtetësisë në arenën ndërkombëtare (Mehmeti, 2013).

Në anën tjetër, dialogu i Brukselit ka prodhuar rezultate të cilat kanë qenë një sfidë e madhe për sistemin unitar të

Republikës së Kosovës. Marrëveshja për drejtësinë dhe ajo për krijimin e AKS-së janë shembuj konkretë. Për më tepër, dialogu i Brukselit, në vend të integritit të serbëve të Kosovës në jetën shoqërore dhe institucionale të Kosovës, ka kontribuar më shumë në ndarjen në baza etnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.

Përfundim

Dialogu i Brukselit nuk ka kontribuar as në forcimin e shtetësisë së Kosovës nga brenda dhe as në konsolidimin saj nga jashtë. Republika e Kosovës vazhdon të ketë vështirësi në kontrollimin dhe ushtrimin e sovranitetit në të gjithë territorin e saj, derisa në arenën ndërkombëtare, Kosova vazhdon të bllokohet nga Serbia në përpjekjet për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare.

Në të njëjtën kohë, dialogu është karakterizuar me mungesë transparence dhe llogaridhënie, të cilat e kanë dobësuar besueshmërinë dhe legjitimitetin e këtij procesi. Dialogu ka qenë një proces mjaft i mbyllur dhe qeveria e Kosovës i ka shmangur debatet dhe diskutimet publike rreth këtij procesi. Për më tepër, i konsideruar si një proces i "pakt-bërjes" se elitave, dialogu i ka munguar besueshmëria dhe mbështetja edhe nga qytetarët e Kosovës. Në anën tjetër, shumica e marrëveshjeve të cilat janë arritur në Bruksel, nuk janë zbatuar fare. Mungesa e zbatimit është rezultat i paqartësisë së përmbajtjes së tyre, mungesës së transparencës dhe në disa raste edhe rezultat i mospërputhjes së tyre me rendin kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, vlen të veçohet Marrëveshja e Prillit, e cila është konsideruar si një e arritur historike në marrëdhëniet Kosovë-Serbi. Disa nga parimet e theksuara në këtë marrëveshje dhe derivatet e saj kanë qenë në shpërputhje me rendin kushtetues dhe unitar të

Republikës së Kosovës. Marrëveshja për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe është vërtetuar nga Gjykata Kushtetuese se është në shpërputhje me frymën kushtetuese të Republikës së Kosovës, përderisa Marrëveshja për drejtësinë ka cënuar sistemin unitar të drejtësisë në Kosovë. Për më tepër, dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit deri më tani, i ka mundur Serbisë të ketë ndikim të konsiderueshëm në Kosovë, qoftë formal apo joformal, duke bërë kështu që Serbia të ushtrojë sovranitet në disa pjesë të Kosovës.

Ndërsa, roli i BE-së në proces ka qenë mjaft kontradiktor. Edhe pse BE ka qenë aktivisht e angazhuar në këtë proces duke i dhënë prioritet stabilitetit mbi sundimin e ligjit dhe demokratizimit, ajo e ka minuar demokratizimin dhe sundimin e ligjit në Kosovë. Edhe mungesa e një politike të unifikuar ndaj Kosovës (për shkak të pesë vendeve të BE-së të cilat nuk e njohin shtetësinë e Kosovës) i ka pamundur BE-së që të ketë një qasje më të qartë në raport me Kosovën dhe të kërkojë njohjen e shtetësisë së Kosovës nga Serbia.

Referencat

Beha, A. (2015). *Disputes over the 15-point agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia*. Nationalities Papers 43(1). (102-112).

Bieber, F. (2017). *What is a stabilitocracy?*, Qendra për studime të Europës juglindore, marrë nga:

<http://www.suedosteuropa.uni-graz.at/biepag/node/245>

Bieber, F. (2015). *The Serbia-Kosovo Agreements: An EU Success Story?*, *Review of Central and East European Law*. (285-319).

Capussela, A. (2015). *State-building in Kosovo. Democracy, Corruption and the EU in the Balkans*. Londër, I.B. Tauris & Co Ltd

Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Aktgjykim në rastin nr. K0130/15, Prishtinë, 23 Dhjetor 2015 Ref. No.:AGJ877/15, I qasshëm në http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_ko_130_15_ang.pdf

Grupi për studime juridike dhe politike (2013). *Kosovo-Serbia Dialogue: Windows of Opportunity or a House of Cards?*. Analizë politike.

Hoogenboom, J.(2011). *The EU as a Peacebuilder in Kosovo*. Civil Society Dialogue Network (CSDN)

Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (2013). *Zbatimi i marreveshjes se dialogut politik Kosove-Serbi*. Analize politike.

Instituti Demokratik i Kosovës (2016). *Transparenca e dialogut Kosovë-Serbi: këndvështrimi i qytetarëve*". E qasshme në <http://votaim.org/Public/Article/DownloadFile/1004>

Instituti Demokratik i Kosovës (2018). *Dialogu Kosovë-serbi në lëgjislaturën e pestë 2014-2017*. I qasshëm në <http://votaim.org/Public/Article?Dialog=true&Dialog=false&SelectedTab=Publications&SelectedMonthID=&SelectedYear=#publications>

Jackson, C. M. (2015). *The EU and civilian crisis management: A case study of EULEX Kosovo and building multi-ethnic rule of law*. Universiteti i Illinois-it

Komisioni European (2018). *A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans*. Strasbourg, I qasshëm në https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-ëestern-balkans_en.pdf

Komisioni European, (2005). *A future for Kosovo*, COM 156. I qasshëm në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52005DC0156>

Karta European për Vetëqeverisje Lokale. Strasbourg 25 October 1985, e qasshme në <https://rm.coe.int/168007a088>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. E qasshme në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta_e.Republikes.se.Kosoves.pdf

LIGJI NR. 05/L -021 PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës. 26.06.2015. I qasshëm në <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

Mehmeti, L.(2013). *Kosovo – Serbia: normalisation of relations or just diplomatic theatre? An analysis of the April 2013 EU brokered agreement between Kosovo and Serbia*. Universiteti i Australisë së Jugut.

Palokaj, A. and Tuhina, GJ. (2016). *“The Upshot of the SAA: Kosovo-EU Relations”*. Kosovo Foundation for Open Society.

Traktati i Lisbonës, 2007/C 306/01. I qasshëm në <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12007L%2FTEXT>

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme. *Rezoluta A/RES/64/298*”, 9 shtator 2010. I qasshëm në, http://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/64/298

Marrëveshja për Drejtësinë. E qasshme në http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Marreveshja_per_Drejtesi_-_09022015.pdf

Marrëveshja e pare e parimeve për normalizimin e marrëdhënieve, Prill 2013. E qasshme në

http://www.votaime.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_19prill2013_HGXf5EDTG4.pdf

Grupi për studime juridike dhe politike (2012). *Nga marrëveshjet politike në pazare politike: - Dialogu Kosovë-Serbi dhe Veri i Kosovës*. Raport politik, Nr. 02

Parlamenti European(2017). *Serbia and Kosovo: Normalisation of relations*. Marrë nga

http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/ATAG/2016/579079/EPRS_ATA%282016%29579079_EN.pdf

Propozimi gjithëpërfshirës i statusit. I qasshëm në http://www.esiëeb.org/pdf/kosovo_Ahtisaari%20Proposal%20.pdf

Van der Borgh, CH., Le Roy, P. dhe Zweerink, F. (2016). *EU peacebuilding capabilities in Kosovo after 2008: an analysis of EULEX and the EU-facilitated Belgrade-Pristina Dialogue*. Qendra për studime të konfliktit. Universiteti i Utrecht-it

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Raportet e ish ministres për dialog. Të qasshme në <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,252>

Burime të tjera nga internet
GazetaExpress, "Serbs campaign against their politicians Slobodan Petrovic and Aleksandar Jablanovic". 11 April 2017. E qasshme në: <http://www.gazetaexpress.com/en/neës/serbs-campaign-against-their-politicians-slobodan-petrovic-and-aleksandar-jablanovic-172377/>

Zeri.info, *Joseph: Serbia do te duhet ta njoh Kosoven para se te hyje ne BE*. 18 gusht, 2016, e qasshme në: <http://zeri.info/aktuale/103815/joseph-serbia-do-te-duhet-ta-njoh-kosoven-para-se-te-hyje-ne-be/>

Marrevëshjet e Brukselit ne pritje te zbatimit. Ministria e dialogut, July 2017

http://votaime.org/Uploads/Data/Documents/RAPORT_Ma rreveshjetBrukselitnePritjetZbatimit_6korrik2017_EgsmJyGV Gx.pdf

Koha Ditore, "Krizat politike në Kosovë çdo ditë me e thellë", 3 Nëntor 2014. E qasshme në

<http://archive.koha.net/?id=27&l=31886>

Balcani Caucaso (OBCT). *Kosovo Serbs, Confusion over the Resolution*. 17 shtator 2010. Marrë nga

<https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/Kosovo-Serbs-Confusion-over-the-Resolution-80292>

Gazeta Blic (2016). *Çka përfiton Kosova nga marrëveshja e 19 Prillit tre vjet më parë?* E qasshme në

<http://gazetablic.com/archive/%E2%80%8Bcka-perfitoi-kosova-nga-marreveshja-e-19-prillit-tre-vjet-me-pare/>

Gazeta Zëri (2015). *KDI: Asociacioni qon në nivel të tretë qeverisës*. I qasshëm në

<http://fax.al/read/nes/1051473/10132399/kdi-asociacioni-con-ne-nivel-te-trete-qeverises> Zeri 2015

Gazeta Blic (2016). *KDI: Marrëveshja nuk krijon një OJQ por qon në nivel të tretë qeverisës*. I qasshëm në

<http://fax.al/read/nes/1051473/10132250/kdi-marreveshja-nuk-krijon-nje-objq-por-qon-ne-nivel-te-trete-qeverises>

